



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:257266

Datë: 05.02.2024

Numri i dokumentit: 05286578

**C.nr.3672/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari Shyqri Hoxha, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.G. me numër personal .... nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës M.A.Sh.T. në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Prishtinë, me objekt të padisë kompensimi i shujtave, me datë **05.02.2024**, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

- I. APROVOHET** e bazuar kërkesëpadija e paditëses D.G. nga Prizreni, **DETYROHET** e paditura, M.A.Sh.T. në Prishtinë, që paditëses në emër të shujtave ditore për 125 ditë pune, (për periudhën prej datës 01.01.2022 deri më datën 21.11.2022) ti paguaj **shumën e përgjithshme prej 250.00 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 05.11.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- II. DETYROHET** e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **124.00 euro**, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësja D.G. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj pranë kësaj gjykate, me datën 05.11.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës M.A.Sh.T. në Prishtinë, me objekt të padisë kompensimin e shujtave, vlera e kontestit 250.00 euro.

I autorizuari i paditëses në padi ka theksuar se paditëses i takon kompensimi për shujtat ditore për vitin 2022 (për periudhën prej datës 01.01.2022 deri më datën

21.11.2022), nga 2 euro në ditë, për çdo ditë pune, për 125 ditë pune, sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për pagesën e shujtave pranë M.A.Sh.T. në Prishtinë, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura, përmes avokaturës shtetërore, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, lidhur me kompensimin e shujtës ditore. Kanë theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me numër 01B/488, të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar. Po ashtu sipas të autorizuarit të të paditurës përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit - SBASHK, ndërsa paditësja nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtarë e sindikatës. Ka shtuat se Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë është tërhequr nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë me nr.prot.01B/105 të datës 22.01.2021 duke bërë kështu që kërkesëpadisë së paditësit ti mungojë baza ligjore pasi me asnjë dispozitë të kësaj kontrate nuk parashihet të ketë veprim retroaktiv për realizimin e kësaj të drejte dhe se me kalimin e afatit për të cilin është lidhur kjo marrëveshje skadon edhe afati i implementimit të saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënëse në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim "Lef Nosi" në Prizren.

Nga vërtetimi i lëshuar me numër reference 86, të datës 16.10.2023, nga drejtori i shkollës së Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim "Lef Nosi" në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se paditësja D.G. nga Prizreni, është në marrëdhënie pune - mësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2022 (për periudhën prej datës 01.01.2022 deri më datën 21.11.2022), ka punuar gjithsej 125 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, pasi vërtetimi është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili si i tillë është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, është përcaktua e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”*.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditësen si punëtores e arsimit-mësimdhënëse, t’ia paguaj kompensimin e shujtave, konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, neni 35 paragrafi 7, pasi që për paditësen D.G. nga Prizreni, kërkesa është bërë e arritshme për 125 ditë pune, përkatësisht për vitin 2022 (për periudhën prej datës 01.01.2022 deri më datën 21.11.2022), apo shuma e përgjithshme prej 250.00 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (05.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.3672/23, datë 05.02.2024**

**G j y q t a r i**

**Shyqri Hoxha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.